

**HALIM PURELLKU****VEPRIMTARIA E KOMITETIT TË KOSOVËS  
NË MBRETËRINË SHQIPTARE NË VITET 1934-1939\***

Sipas burimeve dokumentare jugosllave, pas vrasjes së Bajram Currit dhe më vonë të Hasan Prishtinës, Komiteti i Kosovës thuhet plotësisht ra në letargji.<sup>1</sup> Ai (Komiteti i Kosovës) ekzistonte më tepër si një ide se sa si një organizatë e vërtetë. Deri nga mesi i vitit 1934 përpjekjet e nacionalistëve shqiptarë për të krijuar një organizatë, e cila do t'i drejtonte të gjitha aksionet kundër shtetit jugosllav, rezultuan të pasuksesshme. Në këtë kuadër, edhe tendenca e vazhdueshme e gjeneral Parianit (Alberto Pariani) dhe e ndihmësve të tij për të organizuar Komitetin e Kosovës në Shqipëri, nuk rezultoi me sukses. Mbreti Zogu I e kundërshtonte organizimin e Komitetit të Kosovës në Shqipëri, sepse frikësohej se ai pastaj mund të vepronte kundër interesave të tij.<sup>2</sup>

Mirëpo, pas vrasjes së Hasan Prishtinës (më 14 gusht 1933), i cili drejtonte më parë Komitetin e Kosovës, mbreti Zog ia doli që personalisht ta merrte në duart e veta organizatën e komitetit. Ndërkohë që bërë organizimi i Komitetit të Kosovës në Shqipëri, dhe nga fillimi i gushtit të vitit 1934 burimet dokumentare jugosllave njoftojnë se tani më ekzistonte Komiteti i Kosovës në Shqipëri dhe në Jugosllavi. Mbreti Zog fillimisht, si duket, deri në vitin 1936, Komitetin e administronte me anë të instruksioneve që i jepte nëpërmjet Beqir Rexhës, kapiten i xhandarmërisë shqiptare, me origjinë nga Kërrnjina e Burimit (Istogut), i cili për momentin llogaritej si njeriu më i besuar i tij.<sup>3</sup> Kjo mënyrë e administrimit të Komitetit nga ana e mbretit Zog do të vazhdonte deri në vitin 1936. Në nëntor të vitit 1936 në Vlorë, Komiteti i Kosovës që riorganizuar dhe

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Monarkia Shqiptare, 1928-1939”, organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

<sup>1</sup> *Arhiv Vojnoistorijskog instituta*, Beograd (më tej: *AVII*), popisnik XVII, kut. 95-G, fasc. 2, dok. br. 7, list 22, Стр. Пов. Об. Бр. 144, у Београду, 13.02.1934, Shtabi i Përgjithshëm Kryesor, atasheut ushtarak jugosllav në Shqipëri.

<sup>2</sup> *Po aty*, popisnik XVII, kut. 95-A, fasc. 2, dok. br. 1, list 2 dhe 4, Досије: “Албанско питање”.

<sup>3</sup> *Po aty*, popisnik XVII, kut. 95-A, fasc. 2, dok. br. 1, list 29, За досије: Косовски комитет, У Београду, 10 и 12.08.1934 год.

qe zgjedhur udhëheqja e re me në krye Sali Hoxhën (Vuçiternin).<sup>4</sup> Ndërkaq, figurat kryesore në Komitetin e Kosovës dhe mbase ata, të cilët përbënin kryesinë e re të tij në periudhën nga viti 1934 deri në prill të vitit 1939, ishin: Sali Vuçiterni, ish ministër i qeverisë së parë mbretërore, Ismet bej Kryeziu, ish deputet në parlamentin e Mbretërisë SKS dhe një person i besueshëm i Oborrit mbretëror shqiptar, dhe Bedri bej Pejani.<sup>5</sup> Besohet se në verë të vitit 1937 kryetar i Komitetit të Kosovës ishte Ismet bej Kryeziu, kurse pas tij, deri në verën e vitit 1939, kryetar ishte sërisht Sali Vuçiterni. Mbi kohën e saktë të qëndrimit të tyre në funksionin e kryetarit të Komitetit dhe për të dokumentuar procedurën e zgjedhjes apo të emërimit të tyre ende nuk kemi të dhëna. Ndërkaq dimë se anëtarë të shquar të Komitetit të Kosovës ishin: Sali Moni (Bajraktari), nga Gashi, Xhaferr Spahija, nga Tropoja, Mehmed Alija nga Vlana-prefektura e Kosovës, Baftijar Kollovozi nga Borja e Lumës, Murat Kaloshi nga Maqellara e Dibrës (ky i fundit ishte njëri ndër anëtarët më të rëndësishëm) etj. Të gjithë këta kishin në dispozicion pasuesit e tyre, të gatshëm për çdo aksion që do të synonte realizimin e idesë së Komitetit të Kosovës.

Komiteti i Kosovës kishte ngritur celula-komitete lokale të veta në zonat përgjatë kufirit me Jugosllavinë, të cilat drejtoheshin nga bajraktarët e sipërpërmendur, anëtarë të Komitetit (Sali Moni Bajraktari, Xhaferr Spahija, Mehmed Alija, Baftijar Kollovozi, Murat Kaloshi etj.). Nëpërmjet këtyre celulave zhvilloheshin të gjitha veprimet për organizimin e shqiptarëve në Jugosllavi, si dhe mbajtja e lidhjeve të fuqishme me to. Në këtë drejtim shquhej Memet Alija. Qendra kryesore e celulave ilegale të kosovarëve ishte në Gjakovë. Në raportet e administratës jugosllave të kohës pohohej se edhe ndërmarrja “Rizvanolli” financohej nga Komiteti i Kosovës dhe se ajo ndërmarrje ishte në lidhje të drejtpërdrejtë me Xhaferr Spahiun nga Tropoja.<sup>6</sup>

<sup>4</sup> Pajazit Nushi, “Në vend të parathënies”, në: Hakif Bajrami, *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi (Dokumente)*, Prishtinë: 1996, f. 34.

<sup>5</sup> *Архив на институтот за национална историја* (më tej: *АИИИ*), Скопје, Фонд (në vazhdim: Ф.) Главен генералштаб (në vazhdim: ГГШ), Кутија (në vazhdim: К.) XXXVI/7, Ред, бр. 741, Стр. Пов.Љ. Бр. 1699, у Београду, 23.10.1937, Репорт тремужор (korrik, gusht, shtator 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, fl. 10

<sup>6</sup> *По ату*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 749, Стр. Пов.Об.Бр. 2142, у Београду, 31.07.1939, Репорт тремужор (prill-qershor 1939) i Shtabit të Përgjithshëm jugosllav, Сектори i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, fl. 17; *По ату*, К. XXXVI/7, Ред, бр. 741, Стр. Пов.Љ. Бр. 1699, у Београду, 23.10.1937, Репорт тремужор (korrik, gusht, shtator 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, fq. 10-13; *По ату*, К. XXXVI/7, Ред, бр. 750, Стр. Пов.Љ.Об.Бр. 4037, у Београду, 4.11.1939, Репорт тремужор (korrik, gusht, shtator

Sipas studiuesit Zh. Avramovski, Komiteti i Kosovës që nga viti 1934 kishte ngritur degën (filialin) e tij edhe brenda në Jugosllavi, nën drejtimin e Ferhat Dragës, i cili qëndronte në krye të një Komiteti të përbërë nga një grup i vogël personash: Xhafer Deva, Shaban Mustafa dhe Mustafa Aliu, të gjithë nga Mitrovica. Qendra e kësaj dege ishte në Mitrovicë.<sup>7</sup> Ferhat bej Draga ishte në lidhje të vazhdueshme me qeverinë e Tiranës, nga e cila pranonte edhe ndihma financiare,<sup>8</sup> mbase ai kishte raporte miqësore edhe me mbretin Zog.<sup>9</sup> Kështu, Ferhat Draga, si figurë me shumë autoritet ndër shqiptarët në Jugosllavi, ishte përfaqësuesi i lëvizjes nacionaliste dhe irredentiste të kësaj pjese të popullit shqiptarë, si dhe opozitë e pushtetit jugosllav. Bashkëpunëtor dhe miq të ngushtë të tij konsideroheshin: Iljaz Agushi nga Prishtina, Hafëz Abdullahu, myderriz nga Prizreni, Kadri Saliu, ish avokat nga Gostivari, i cili, siç shprehej bani i Banovinës së Vardarit, “për nga ndërgjegjja dhe kombësia është po i njëjtë si Ferhat Draga dhe haptazi është mik personal i tij”. Për autoritetet lokale jugosllave, Kadri Saliu ishte i dyshuar edhe si bashkëpunëtor i Komitetit të Kosovës.<sup>10</sup>

Duhet theksuar, se ishin disa faktorë që i mundësuan Zogut ta shtinte nën shtetull Komitetin e Kosovës në periudhën e viteve 1934-1939. Ndoshta faktori kryesor ishte se me mbretin Zog mund të realizohet objektivi i bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.<sup>11</sup> Por, ritmet dhe dimensionet e veprimtarisë dhe të aksioneve të Komitetit të Kosovës determinoheshin nga më shumë faktorë, si: pozita ndërkombëtare e shtetit shqiptar, ecuria e marrëdhënieve midis Italisë

---

1939) i Shtabit të Përgjithshëm Kryesor jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, fq. 9.

<sup>7</sup> *AVII*, Beograd, popisnik XVII, kut. 95<sup>-A</sup>, fasc. 2, dok. br. 1, list 29, За досије: Косовски комитет, У Београду, 10 и 12.08.1934 год.

<sup>8</sup> Živko Avramovski, “Prilog pitanju italiansko-albanske irredentističke propagande na Kosovu i Metohiji u vreme Minhenske krize i okupacije Albanije”, *Историјски гласник*, 2-3, Београд, 1964, f. 123.

<sup>9</sup> *АИИИ*, Скопје, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 727, Пов.Ћ.Об.Бр. 10135, Београд, 28.07.1939; По ату, К. XXXVI/7, Ред, бр. 750, Стр.Пов.Ћ.Об.Бр. 4037, у Београду, 4.11.1939, Raport tremujor (korrik, gusht, shtator 1939) i Shtabit të Përgjithshëm Kryesor jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, fl. 9.

<sup>10</sup> По ату, ФК. 173, Инв. бр. 137/71, Преписка на Министерството за надворешни работи на предвојна југославија, Стр. Пов. Каб. Бр. Службено, Скопје, 21.06.1937, Вани i Vanovinës së Vardarit, kryeministrin dr. Millan Stojadinoviqit; *AVII*, Beograd, popisnik XVII, kut. 95<sup>-B</sup>, fasc. 4, dok. br. 10, list 1, Стр. Пов. Ћ. Об. 2. Бр. 723, Београд, 1940, Досије: Политичке прилике у Ј. Србији.

<sup>11</sup> По ату, Скопје, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 767, Raport mujor mbi gjendjen e brendshme politike në Mbretërinë e Jugosllavisë për muajin janar 1939, Београд, 4.02.1939, fl. 10.

dhe Jugosllavisë, dhe në këtë kuadër, përplasja e interesave të tyre jo vetëm në Shqipëri, por dhe në Kosovë; konstalacionet politike e diplomatike rajonale e ndërkombëtare; zhvillimet e brendshme politike në shtetin shqiptar; pozita shoqërore e shqiptarëve nën sundimin jugosllav etj.<sup>12</sup>

Në harkun kohor të viteve 1934-1936, burimet dokumentare nuk japin të dhëna për ndonjë veprim konkret politik ose revolucionar të Komitetit të Kosovës në territorin e Jugosllavisë. Mbase veprimtaria e Komitetit që kufizuar vetëm në aksione mobilizuese. Kjo me siguri u dedikohet zhvillimeve të brendshme politike dhe orientimit (kursit) të ri të politikës së jashtme të Mbretërisë Shqiptare në raport me Jugosllavinë. Sipas burimeve diplomatike britanike, marrëdhëniet bilaterale midis Tiranës e Beogradit gjatë gjithë vitit 1934 mbetën miqësore. Ato u pasuruan me marrëveshje të reja plotësuese mbi tregtinë dhe detarinë.<sup>13</sup> Marrëdhënie të tilla midis dy vendeve vazhduan deri nga mesi i vitit 1935 kur sërish rifilloi tensionimi, pasi Shqipëria u orientua sërish dhe rifilloi të kreditohej nga Italia.<sup>14</sup> Pas marrëveshjeve të reja ekonomike dhe politike-ushtarake midis Italisë dhe Shqipërisë, të 19 marsit 1936, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave sërish i karakterizoi atmosfera e mosbesimit reciprok, sikurse disa vite më parë.<sup>15</sup> Një element tjetër që i acaronte marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishte politika jugosllave e shpronësimit të dhunshëm e sistematik të shqiptarëve në Jugosllavi nga pronat e tyre dhe kolonizimi i serbëve në ata pronat, si dhe politika e shpërnguljes së dhunshme masive të shqiptarëve për në Turqi e Shqipëri, të cilat vazhdonin që nga fundi i Luftës Botërore.<sup>16</sup>

Për të penguar shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve nga Kosova, Shqipëria në rrugë diplomatike do të drejtohet për ndihmë edhe Britanisë, në gusht të vitit 1935.<sup>17</sup> Mirëpo presioni i pushtetit jugosllav ndaj shqiptarëve në Jugosllavi po shtoej dhe po arrinte përmasat e persekutimit.<sup>18</sup> Në këtë kuadër, figuron edhe një Urdhëresë Tepër rezervat II. Nr. 6 e 29 prillit 1936, mbi

<sup>12</sup> Ž. Avramovski, "Prilog pitanju...", f. 123-126 dhe 129; Tajni arhivi grofa Ciana (1936-1942), Zagreb, 1952, f. 214 dhe 228.

<sup>13</sup> Živko Avramovski, "Britanci o Kraljevini Jugoslaviji", në: *Godišnji izveštaji Britanskog poslansva u Beogradu 1921-1938*, knjiga druga (1931-1938), Zagreb, 1986, f. 239.

<sup>14</sup> *Po aty*, f. 314.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 414-415.

<sup>16</sup> Ž. Avramovski, "Prilog pitanju...", f. 123-125.

<sup>17</sup> Po ai, "Britanci o Kraljevini...", f. 314-315.

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 415-416.

shpërnguljen e shqiptarëve e lëshuar nga Administrata mbretërore jugosllave e Banovinës së Vardarit.<sup>19</sup>

Masat e ndërmarra nga pushteti jugosllav për shpërnguljen e shqiptarëve, si dhe tendosja e marrëdhënieve dypalëshe midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, si duket vuri në lëvizje në vitin 1936 edhe irredentizmin shqiptar, që sipas gjasave duhet të ketë pasur mbështetje nga qeveria e Mehdi Frashërit. Sipas burimeve diplomatike jugosllave, Mehdi Frashëri po ndiqte një politikë proitaliane, sepse ishte i bindur se me ndihmën e Italisë do të mund të realizonte idenë e bashkimit të të gjithë shqiptarëve në një shtet.<sup>20</sup> Në korrik të vitit 1936, ka të dhëna për një agjitacion të fuqishëm për popullatën shqiptare të rrethit të Dibrës, për të përballuar stoikisht reprezaljet e pushtetit jugosllav dhe për të qëndruar me çdo kusht në vatrën e vet, me premtimin se deri në vjeshtë shqiptarët e atjeshëm do të jenë në kuadër të “shtetit të tyre”. Gjithashtu bëhej fjalë edhe rreth përgatitjes së “një kryengritje shqiptare” në këtë rreth, për t’u çliruar nga sundimi serb, mbi bazën e një programi të hartuar nga Abdurrahman Krosi (Dibra) nga Tirana.<sup>21</sup>

Ndërkaq, me negociatat italo-jugosllave të janar-marsit 1937, të zhvilluara në Romë, për arritjen e një pakti të miqësisë, midis dy vendeve ku politika ndaj Shqipërisë ishte një nga çështjet kryesore që u shqyrtua,<sup>22</sup> u shënua kthesë në marrëdhëniet italo-jugosllave. Me paktin italo-jugosllav të 25 marsit 1937, të cilin Ivo Andriqi e ka vlerësuar si “modus vivendi” të tolerueshëm ndërmjet Jugosllavisë dhe Italisë në terrenin shqiptar,<sup>23</sup> ra relevansa gjeostrategjike ndërkombëtare e Shqipërisë. Çështja e Shqipërisë në të kaluarën “ka luajtur rol më vendimtar në momente përcaktuese në marrëdhëniet italo-jugosllave”, por tani, në atmosferën e re në marrëdhëniet italo-jugosllave, kjo çështje do të shndërrohet në “problem modest lokal”, vlerësonin më vonë Çiano dhe Stojadinović, kryeministri jugosllav.<sup>24</sup> Pra, me Paktin italo-jugosllav të 1937, rreziku latent i një konflikti midis Italisë dhe

<sup>19</sup> АИНИ, Скопје, Ф. Трета армисјска област (мë tej: ТАО), К. XXXV/6, Ред, бр. 697, Инв. бр. 1786, Пов.Ћ.Об.Бр. 1786, Скопље, 27.08.1936, Shtabi i Armatës III, kryeshefit të Shtabit të Përgjithshëm Kryesor.

<sup>20</sup> Ž. Avramovski, “Britanci o Kraljevini...”, f. 415-referenca nr. 14.

<sup>21</sup> АИНИ, Скопје, Ф. ТАО, К. XXXV/6, Ред, бр. 697, Инв. бр. 1786, Пов.Ћ.Об.Бр. 1786, Скопље, 27.08.1936, Shtabi i Armatës III, kryeshefit të Shtabit të Përgjithshëm Kryesor.

<sup>22</sup> По ату, ФК. 173, Инв. бр. 137/71, Строго Поверливо, Рим, 11 марта 1937 године, Пети извештај о разговорима у Риму (7 марта-9 марта), si duket është raport i G. Subotiq, i cili ishte negociatori kryesor për palën jugosllave.

<sup>23</sup> По ату, ФК. 173, Инв. бр. 137/71, Referat, i Ivo Andriqit, 30.01.1939.

<sup>24</sup> Tajni arhivi grofa Ciana (1936-1942), Zagreb, 1952, f. 116-117 dhe 128.

Jugosllavisë rreth Shqipërisë u relativizua,<sup>25</sup> dhe në këtë kuadër ky pakt paralajmëroi ndryshimin e gjendjes në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.<sup>26</sup> Megjithatë, shteti shqiptar dhe Monarkia shqiptare vazhdonin të ishin qendër joshëse për një numër të konsiderueshëm emigrantësh shqiptarë, pra edhe për Komitetin e Kosovës.<sup>27</sup> Sipas burimeve dokumentare jugosllave, në verë të vitit 1937 të gjithë kosovarët dhe të arratisurit e tjerë nga Jugosllavia në Shqipëri, ishin të armatosur.<sup>28</sup> Jankoviq, ministri jugosllav në Tiranë, në një raport të tij të vitit 1937, vlerëson se: “shqiptarët i kanë dhënë Italisë shumë koncesione, por deri më tani asaj nuk ia kanë dhënë shpirtin e vet dhe patriotizmin e vet. Shqipëria nuk ka abdikuar nga pavarësia dhe liria”.<sup>29</sup>

Nga ana tjetër, ndryshimi i gjendjes në marrëdhëniet dypalëshe midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, rezultoi me intensifikimin e fushatave sistematike të represionit nga ana e pushtetit jugosllav mbi shqiptarët në Jugosllavi, por dhe me paraqitjen në skenë të Komiteti të Kosovës në rol shumë më aktiv. Komiteti i Kosovës pasi u konsolidua në nëntor të vitit 1936 nën drejtimin e një kryesie të re me në krye Sali Vuçiernin, në vitin 1937 intensifikoi veprimet dhe aksionet politike e revolucionare.<sup>30</sup> Gjatë muajve mars-prill 1937 Komiteti i Kosovës po përgatiste në Shqipëri tri grupe “kaçakësh”, që do të hidheshin në territorin e Jugosllavisë. Grupi i parë do të duhej të përbëhej nga: Feriz Salku, një udhëheqës i çetave kryengritëse të drejtuara nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” që para vitit 1924, Huso Kolena nga rrethi i Jenipazarit, banues në fshatin Fusha Balonës të Fierit, Idriz Shabani nga rrethi i Sjenicës, banues në rrethin e Lushnjës, Ismet Rasovaci nga Duga Poljana, banues në rrethin e Kavajës, Jonuz dhe Rakë Bisheva, banues në Fier, Hako Hamza nga Peja, banues në Lushnjë, Bislim Bajgora dhe do të tjerë. Grupi i dytë do të

<sup>25</sup> Vuk Vinaver, “Çështja shqiptare” në shtypin e PKJ 1919-1939”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, I-1971, Prishtinë: 1972, f. 93.

<sup>26</sup> Ž. Avramovski, “Britanci o Kraljevini...”, f. 539.

<sup>27</sup> АИИИ, Скопје, ФК. 173, Инв. бр. 137/71, Приватно, Београд, 3.02.1939 год., Relatë private e Ivan Vukotiq, ministër fuqiplotë jugosllav në Shqipëri, kryeministrit Millan Stojadinoviq.

<sup>28</sup> *Po aty*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред. бр. 741, Стр. Пов.Б. Бр. 1699, у Београду, 23.10.1937, Raport tremujor (korrik, gusht, shtator 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, f. 10.

<sup>29</sup> *Po aty*, ФК. 173, Инв. бр. 137/71, Реферат посланика г. Јанковића о Албанији, па датë. (Në bazë të përmbajtjes së referatit, si dhe të një raporti të Jankoviqit, të 15 shkurtit 1937, drejtuar Stojadinoviqit, me anë të të cilit e njofton se ka përgatitur një referat mbi Shqipërinë dhe se së shpejti do t’ia dërgon atij, mund të përfundojmë se ky referat është hartuar në fillim të vitit 1937).

<sup>30</sup> *Po aty*, ФК. 173, Инв. бр. 137/71, Приватно, Београд, 3.02.1939 год., Relatë private e Ivan Vukotiq, ministër fuqiplotë jugosllav në Shqipëri, kryeministrit Millan Stojadinoviq.

përbëhej nga Huka dhe Haka Boshnjaku nga Jenipazari, Hajdar Boshnjaku nga Rozhaja dhe një malazez, të cilët banonin në Shkodër. Grupi i tretë do të përbëhej nga Preng Pali, pari nga Vermoshi, me disa njerëz të tij.

Gjatë tre muajve të parë të vitit 1937 nuk pati aksione nga kaçakët ose komitetët e armatosur.<sup>31</sup> Aksionet e tyre filluan nga muaji prill dhe do të vazhdonin deri në dhjetor të vitit 1937. Gjatë tre muajve: prill, maj, qershor 1937 pati më shumë aksione të grupeve të armatosura shqiptare për të kaluar në mënyrë ilegale kufirin nga Shqipëria në Jugosllavi, përkatësisht në Kosovë, për motive të ndryshme, do të thotë edhe të kontrabandës me duhan. Shtatë nga ato aksione rezultuan me shkëmbim zjarri midis grupeve shqiptare dhe forcave kufitare jugosllave, me ç'rast pati të plagosur dhe dy të vrarë nga radhët e grupeve shqiptar, kurse nga radhët e forcave kufitare jugosllave nuk pati as të plagosur e as të vrarë.<sup>32</sup>

Ndërkohë, gjatë muajve maj-qershor 1937 u zhvilluan bisedimet dypalëshe shqiptaro-jugosllave për avancimin e marrëdhënieve ndërshtetërore. Në këto bisedime pala shqiptare tentoi të ngrinte edhe çështjen e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi, por kjo çështje nga pala jugosllave apriori u refuzua.<sup>33</sup> Në këtë kuadër, ministri shqiptar i Punëve të Jashtme e siguronte ministrin britanik në Shqipëri ser A. Ryan se qeveria shqiptare nuk kishte kërkesa irredentiste ndaj Jugosllavisë. Një qëndrim të tillë të ministrit shqiptar, ministri britanik e lidhte me ndryshimin e gjendjes në marrëdhëniet ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë, me paktin e 25 marsit 1937.<sup>34</sup> Në frymën e përmirësimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë, qeveria shqiptare kishte ndërmarrë një fushatë arrestimesh dhe internimesh të kosovarëve dhe të anëtarëve të Komitetit të Kosovës, gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator 1937, me qëllim që të pengonte aktivitetet dhe aksionet e tyre kundër Jugosllavisë. Qe arrestuar në Tiranë kaçaku i njohur Mehmet Maloku, nga Kosova, me 40 shokë, dhe arrestimet vazhdonin.

Megjithatë aksionet ilegale të grupeve të vogla të armatosura shqiptare për të kaluar kufirin shqiptaro-jugosllav nga të dyja anët e tij do të vazhdonin. Nga muaji korrik e deri në dhjetor të vitit 1937, pati rreth nëntëmbëdhjetë përpjekje të armatosura midis grupeve shqiptare që tentonin ta kalonin

<sup>31</sup> *Po aty*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 739, Raport tremujor mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, 10.04.1937, fq. 10-11; *Po aty*, К. XXXVI/8, Red. br. 805, Pov. J. Br. 2989, Beograd, 8.11.1924, Udhëzim mbi punën e xhandarmerisë me qëllim të zhdukjes së bandave kaçake në Serbin Jugore.

<sup>32</sup> *Po aty*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 740, Стр. Пов. Б. Об. Бр. 1137, y Beogrady, 6.07.1937, Raport tremujor mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat për muajt prill, maj dhe qershor 1937, f. 13-16.

<sup>33</sup> Ž. Avramovski, "Prilog pitanju..." , f. 124.

<sup>34</sup> Po ai, Britanci o Kraljevini Jugoslaviji... ", f. 540.

ilegalisht kufirin me forcat kufitare jugosllave. Disa nga këto përpjekje rezultuan me viktima: 2 të vrarë dhe 4 të plagosur nga radhët e grupeve shqiptare, kurse 2 të vrarë dhe 2 të plagosur nga radhët e forcave kufitare jugosllave. Burimet ushtarake jugosllave kryesisht nuk bëjnë fjalë për motivet e kalimit të kufirit nga ana e këtyre grupeve shqiptare, por i karakterizojnë si “aksione në terren” të Komitetit të Kosovës.<sup>35</sup> Ndërkaq, ministri jugosllav në Shqipëri përpara diplomatëve të huaj i cilëson ato aksione si “incidente kufitare” për motive të kontrabandës së duhanit, të provokuara nga ana e “plaçkitësve” shqiptarë nga Jugosllavia, të cilët jetonin si emigrantë në Shqipëri. Sipas tij gjatë vitit 1937 u shënuan 19 aksione të tilla, gjatë të cilave pati disa viktima nga pala jugosllave,<sup>36</sup> por nga sa u tha më sipër, sipas vetë burimeve ushtarake jugosllave, ky numër i aksioneve ishte shumë më i madh dhe sillej së paku në 26.

Gjatë vitit 1938, sipas burimeve diplomatike britanike, nuk kishte ndryshime të mëdha në marrëdhëniet midis Jugosllavisë e Shqipërisë. Nuk pati as incidente kufitare.<sup>37</sup> Deri në muajin maj 1938 nuk qe hetuar kurrfarë aktiviteti serioz i “propagandës shqiptare” e as ndonjë aksion i “propagandës irredentiste shqiptare” në Jugosllavi.<sup>38</sup> Mirëpo lajmet mbi përgatitjen e Konventës jugosllavo-turke (11 korrik 1938) për shpërnguljen masive të “myslimanëve”, përkatësisht të shqiptarëve nga Jugosllavia, shkaktuan alarm të madh, thujse në shkallë kushtrimi, në Shqipëri.<sup>39</sup> Qeveria shqiptare nga fundi i vitit 1938 zhvillonte një aksion të planifikuar politik e diplomatik në vend dhe jashtë, për ngritjen e çështjes së Kosovës.<sup>40</sup> Ndërkohë nga ana e një numri

<sup>35</sup> АИИИ, Скопје, Ф. ГГШ., К. XXXVI/7, Ред. бр. 741, Стр. Пов. Ы. Бр. 1699, у Београду, 23.10.1937, Raport tremujor (korrik, gusht, shtator 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, f. 10-13; Po aty, К. XXXVI/7, Ред. бр. 742, Стр. Пов. Ы. Об. Бр. 84, Београд, 22.01.1938, Raport tremujor (tetor, nëntor dhe dhjetor 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, f. 15-17.

<sup>36</sup> Ž. Avramovski, “Britanci o Kraljevini...”, f. 540.

<sup>37</sup> Po aty, f. 648.

<sup>38</sup> АИИИ, Скопје, Ф. Стојадиновћ, К. XXXIX/25, Ред. бр. 48, Терџер резерват, Бuletin, Сектори пџр Мbrojtjen e Shtetit i Ministrisџе сџе ПВ пџр муajин мај 1938, fl. 15.

<sup>39</sup> Ž. Avramovski, “Prilog pitanju...”, f. 128.

<sup>40</sup> АИИИ, Скопје, Ф. ГГШ., К. XXXVI/7, Ред. бр. 748, Стр. Пов.. Об. Бр. 1123, у Београду, 28.04.1939, Raport tremujor (janar-mars 1939) i Shtabit тџ Pџrgjithshџm jugosllav, Сектори i Zbulimit, mbi komitetet: Маqedonas, тџ Kosovџс dhe Kroat, f. 15-17; *Државен архив на Република Македонија* (мџ теј: ДАРМ), Скопје, Ф. 1178-Бугарско трговско агенство во Тирана, кут. 1, арх. един. 28, стр. 77-78 (нџ vazhdim sipas кџтџ shembulli: ДАРМ, Скопје, 1178.1.28/57-58), Т.А.Нг. 338, Тирана, 14 Октовмвриј 1938 г., Raport i Peevit, i ngarkuari me punџ i Bullgarisџе нџ Shqipџри, Qoseivanovit, ministrit bullgarџ тџ ПЈ; Dr. Hakif Bajrami, *Dџbimi dhe shpџrngulja e*

studentësh, të rinjsh dhe emigrantësh shqiptarë nga Kosova, si dhe të disa deputetëve, në tetor të vitit 1938 bëheshin përgatitje për organizimin e manifestimeve dhe protestave kundër Konventës jugosllavo-turke në Tiranë, Korçë, Shkodër etj. Njëherazi, nga këto mitingje do t'iu kërkohej qeverisë shqiptare dhe Fuqive të Mëdha të ndërhyenin në Beograd, në favor të njohjes së të drejtave pakicës shqiptarëve në Jugosllavi, mundësisht të ngrihej edhe çështja e vetëvendosjes së shqiptarëve në Jugosllavi. Nga alarmi i Tiranës nuk mbeti immune edhe qeveria turke në Ankara. Përfaqësuesi diplomatik turk në Tiranë, para kolegëve të tij, sigurisht edhe para autoriteteve qendrore shqiptare, dha shpjegime se Turqia me këtë Konventë nuk synonte të dëmtonte elementin shqiptar në Jugosllavi dhe se do të merrte masa të nevojshme që në procesin e shpërnguljes të përfshihej vetëm elementi turk.<sup>41</sup>

Njëkohësisht asokohe nga paria shqiptare qe ndërmarrë një aksion politik edhe ndër shqiptarët në Jugosllavi, për të parandaluar shpërnguljen e tyre për në Turqi, të bindur “se ekziston zgjidhje për çështjen e tyre”.<sup>42</sup> Në këtë kuadër, Irredenta shqiptare, nën drejtimin e Ferhat Dragës, kishte intensifikuar, “si asnjëherë më parë”, aksionet e saj propagandistike për bashkimin e tokave shqiptare në Jugosllavi me Shqipërinë.<sup>43</sup> Organet policore jugosllave, nga fundi i vitit 1938, përmendin dhe një “Proklamatë” të Komitetit të Kosovës për shtimin e ndërëgjegjes për “Mëmën Shqipëri” ndër shqiptarët në Jugosllavi. Sipas këtyre organeve, Naim bej Starova, emigrant nga Shqipëria, shquhej për veprimtarinë e tij ndër shqiptarët në Tetovë në frymën e kësaj proklamate.<sup>44</sup> Ndërkaq, Nazif Nushi nga Peja, nënshtetas shqiptar, pjesëtar i Shërbimit të Zbulimit të policisë shqiptare, i cili në mënyrë të ligjshme vizitoi Jugosllavinë, në nëntor 1938, qëndroi në Gjakovë, Shkup dhe Pejë, nga organet jugosllave

*shqiptarëve në Turqi* (Dokumente), Prishtinë: 1996, f. 294-295; Ž. Avramovski, “Prilog pitanju...”, f. 127-128.

<sup>41</sup> ДАРМ, Скопје, 1178.1.28/57-58, Т.А.№г. 338, Тирана, 14 Октовмвриј 1938 г., Raport i Peevit, i ngarkuari me punë i Bullgarisë në Shqipëri, Qoseivanovit, ministrit bullgarë të PJ; *Po aty*, 1178.1.57/112-113, Т.А.№г. 353, Тирана, 21 Октовмвриј 1938 г., Raport i Peevit, Qoseivanovit; *Po aty*, 1178.1.55/109-110, Т.А.№г. 358, Тирана, 23 Октовмвриј 1938 г., Raport i Peevit, Qoseivanovit; *Po aty*, 1178.1.54/108, Т.А.№г. 363, Тирана, 25 Октовмвриј 1938 г., Raport i Peevit, Qoseivanovit; Ž. Avramovski, “Britanci o Kraljevini...”, f.648-referenca 33; Po ai, “Prilog pitanju ...”, f. 128.

<sup>42</sup> Ž. Avramovski, “Britanci o Kraljevini...”, f. 648-referenca 33.

<sup>43</sup> Po ai, “Prilog pitanju...”, f. 126-129; Vuk Vinaver, *pun. i për.*, f. 94.

<sup>44</sup> АИНИ, Скопје, Ф. ТАО, К. XXXV/6, Ред, бр. 612, Пов. Ђ. Об. Бр. 1241, Скопље, 30.12.1938, Komandanti i Armatës III, komandantit të Regjimentit të xhandarmerisë së Vardarit; *Po aty*, Пов. Бр. 2, у Тетову, 18.01.1939, Komandanti i Çetësh të xhandarmerisë së Tetovës, komandantit të Regjimentit të xhandarmerisë së Vardarit.

dyshohej se kishte ardhur me mision të veçantë politik.<sup>45</sup> Por burimet dokumentare jugosllave nuk njoftojnë për incidente kufitare e as për “aksione në terren” nga ana e Komitetit të Kosovës gjatë vitit 1938.

Pas paralajmërimeve mbi ripërtëritjen e kërkesave irredentiste shqiptare, në tetor të vitit 1938 ministri jugosllav në Shqipëri i tërhoqi vërejtjen kolegut të tij britanik, mbi “tendencën e shqiptarëve për të luajtur me irredentizmin.”<sup>46</sup> Meqë irredentizmi shqiptar po i prishte planet e Italisë në raport me Jugosllavinë, nga fundi i vitit 1938 qeveria italiane i sugjeroi qeverisë shqiptare që të ndalonte një aksion të tillë. Duket se sugjerimi i Italisë pati ndikim në zbutjen e fushatës irredentiste.<sup>47</sup>

Pavarësisht nga qëndrimi italian i sipërpërmendur, sipas burimeve arkivore jugosllave, aksioni irredentist shqiptar, të cilin “e drejtonte regjimi i Mbretit Zog”, nuk ishte ndërprerë edhe në fillim të vitit 1939. Gjatë muajit janar 1939, paria shqiptare në Kosovë; Sherif Voca etj., vazhdonte aktivitetet e saja politike për forcimin e ndërgjegjes kombëtare ndër shqiptarët, me qëllim që të përgatitej terreni për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, në momentin kur për këtë të paraqiteshin rrethanat e volitshme. Paria pohonte se po afronte ora e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Në funksion të këtij qëllimi qe dhe shpërndarja e hartës irredentiste të Shqipërisë. Mbase bëhet fjalë për hartën “Shqipëria e Vërtetë”, e cila u shpërmda edhe në territoret e Jugosllavisë. Kështu, në prag të pushtimit të Shqipërisë nga Italia, veprimi politik shqiptar për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare te popullsia shqiptare në Jugosllavi, deri diku ishte i suksesshëm.<sup>48</sup> Mirëpo, as gjatë tre muajve të parë të vitit 1939, pos këtyre aksioneve politike, nuk pati ndonjë aksion tjetër revolucionar në terren

<sup>45</sup> *Po aty*, Ф. ТАО, К. XXXV/6, Ред, бр. 615, Ин. бр. 79, Пов. Б. Бр. 36, Цетинье, 24.01.1939, Regjimenti i xhandarmerisë së Zetës, komandantit të Armatës III; *Po aty*, К. XXXV/6, Ред. Бр. 623, Инв. бр. 79, Пов. Ђ. Об. Бр. 79, Скопље, 30.02.1939, Shtabi i Armatës III, Drejtorisë së policisë-Shkup.

<sup>46</sup> Ž. Avramovski, “Britanci o Kraljevini...”, f. 648.

<sup>47</sup> *Po ai*, “Prilog pitanju...”, f. 129.

<sup>48</sup> АИИИ, Скопје, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 767, Raport mujor mbi gjendjen e brendshme politike në Mbretërinë e Jugosllavisë për muajin janar 1939, Beograd, 4.02.1939; *Po aty*, К. XXXVI/7, Ред, бр. 770, Raport mujor mbi gjendjen e brendshme politike në Mbretërinë e Jugosllavisë për muajin korrik 1939, Beograd, 15.08.1939, fq. 13-14; *Po aty*, Ф. ТАО, К. XXXV/6, Ред, бр. 649, Инв. бр. 465, Пов. Ђ.Об.Бр. 465, Скопље, 4.05.1939, Shtabi i Armatës III-Raport informativ mujor për muajin prill 1939 mbi situatën e brendshme; *Po aty*, К. XXXV/6, Ред, бр. 654, Инв. бр. 935, Пов. Ђ.Об.Бр. 935, Скопље, 4.08.1939, Raport informativ mujor i Shtabit të Armatës III (jugosllave) për muajin korrik 1939 mbi situatën e brendshme.

nga ana e kosovarëve e as nga Komiteti i Kosovës kundër interesave të Jugosllavisë.<sup>49</sup>

Në prag të agresionit italian ndaj Shqipërisë duket se Komitetin e Kosovës po e mbërthente një krizë e brendshme. Arsyet për momentin mbeten të panjohura. Lidhur me këtë, indikative është arratisja në Jugosllavi në mars të vitit 1939 e Mehmet Alijës dhe e Murat Kaloshit, dy anëtarë të komitetit nga më aktivët dhe më të rëndësishmit. Menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë nga ana e Italisë, Komiteti i Kosovës pushoi aktivitetin e tij, sikur të mos ekzistonte. Autoritetet italiane në Shqipëri, shpejt pas pushtimit të vendit, deri nga mesi i dhjetorit të vitit 1939, e ndaluan veprimtarinë e Komitetit të Kosovës, me siguri për shkak se pjesa më e madhe e anëtarëve të Komitetit të Kosovës kishin qëndrim kundëritalian dhe ishin për veprime kundër Italisë.<sup>50</sup> Autoritetet italiane, sipas të gjitha gjasave, në verë të vitit 1939 kishin internuar Sali Vuçiternin, kryetarin e Komitetit, me pretekst se kishte refuzuar ofertën e organizatës bullgaro-maqedonase OBRM (VMRO) për veprim të përbashkët në “Serbinë e Jugut”.<sup>51</sup> Pas këtyre masave të italianëve kundër Komitetit të Kosovës, përfundoi edhe kjo fazë e veprimtarisë së tij.

Do theksuar se autoritetet ushtarake e policore jugosllave nuk ishin në dijeni për far raportesh midis Komitetit të Kosovës me organizata të tjera të ngjashme, qoftë me Komitetin Maqedonas apo me Komitetin Kroat, gjatë kësaj faze të veprimtarisë së tij.<sup>52</sup>

<sup>49</sup> *Po aty*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 747, ?o4.1939, Shkurtim nga Raporti mujor (janar-mars) i Shtabit të Përgjithshëm jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat; *Po aty*, К. XXXVI/7, Ред, бр. 748, Стр. Пов. Об. Бр. 1123, у Београду, 28.04.1939, Raport tremujor (janar-mars 1939) i Shtabit të Përgjithshëm jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, f. 15-17.

<sup>50</sup> *АИИИ*, Скопје, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 749, Стр. Пов.Об.Бр. 2142, у Београду, 31.07.1939, Raport tremujor (prill-qershor 1939) i Shtabit të Përgjithshëm jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, f. 8-9 dhe 17; *Po aty*, К. XXXVI/7, Ред, бр. 746, Shkurtim nga Raport mujor (prill-qershor 1939) mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat; *Po aty*, К. XXXV/7, Ред, бр. 751, Пов. Ђ. Об. Бр. 218, Скопље, 24.01.1940, Raport tremujor (tetor, nëntor, dhjetor 1939) i Shtabit të Përgjithshëm Kryesor jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, f. 5-6.

<sup>51</sup> *Po aty*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 750, Стр.Пов.Ђ.Об.Бр. 4037, у Београду, 4.11.1939, Raport tremujor (korrik, gusht, shtator 1939) i Shtabit të Përgjithshëm Kryesor jugosllav, Sektori i Zbulimit, mbi komitetet: Maqedonas, të Kosovës dhe Kroat, fl. 9.

<sup>52</sup> *Po aty*, Ф. ГГШ, К. XXXVI/7, Ред, бр. 739, Raport tremujor mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, 10.04.1937, fl. 7; *Po aty*, К. XXXVI/7, Ред, бр. 740, Стр. Пов. Б. Об. Бр. 1137, у Београду, 6.07.1937, Raport

---

tremujor mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat për muajt prill, maj dhe qershor 1937, fl. 9; *Po aty*, K. XXXVI/7, Ред, бр. 741, Стр. Пов.Б. Бр. 1699, у Београду, 23.10.1937, Raport tremujor (korrik, gusht, shtator 1937) mbi veprimtarinë e Komitetit Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, f. 7; *Po aty*, K. XXXVI/7, Ред, бр. 747, Shkurtesë, nga raporti mujor mbi Komitetet Maqedonas, të Kosovës dhe atij Kroat, për muajt janar, shkurt dhe mars 1939.